



TERMA REFERENCE (ToR)

Pozicioni: Punonjës Social

Qendra Sociale Multifunkionale e Specializuar për Personat me Aftësi të Kufizuara

Organizata: Shoqata “NdiHmoni Jetën”

Vendndodhja: Fshati Prush, Njësia Administrative Vaqarr, Tiranë

Kohëzgjatja e kontratës: 12 muaj (me mundësi rinovimi)

Forma e punësimit: Me kohë të plotë

1. Hyrje – Qëllimi i shërbimit

Qendra Sociale Multifunkionale e Specializuar për Personat me Aftësi të Kufizuara, e administruar nga Shoqata “NdiHmoni Jetën”, ka për qëllim ofrimin e shërbimeve të integruara sociale, dhe mbështetëse për persona me aftësi të kufizuara intelektuale dhe me çrregullim të spektrit të autizmit, si dhe për familjet dhe kujdestarët e tyre. Qendra synon të përmirësojë cilësinë e jetës së përfituesve, të rrisë pavarësinë, autonominë dhe aftësitë funksionale të tyre, si dhe të promovojë përfshirjen aktive sociale dhe komunitare, në përputhje me parimet e jetesës së pavarur, barazisë, mosdiskriminimit dhe respektimit të dinjitetit njerëzor.

2. Përshkrimi i rolit

Punonjësi Social është pjesë e ekipit multidisiplinar të Qendrës dhe ka rol qendror në vlerësimin social, planifikimin dhe ofrimin e shërbimeve mbështetëse për përfituesit dhe familjet e tyre. Roli i Punonjësit Social konsiston në identifikimin e nevojave sociale, hartimin dhe zbatimin e planeve individuale të mbështetjes sociale, ndërmjetësimin me institucionet dhe shërbimet komunitare, si dhe në fuqizimin e familjeve dhe kujdestarëve për të përmirësuar mirëqenien dhe përfshirjen sociale të përfituesve.

3. Detyrat dhe përgjegjësitë e përgjithshme

Punonjësi/ja do të:

- Kryejë vlerësime sociale fillestare dhe periodike për përfituesit dhe familjet e tyre;
- Hartojë dhe zbatojë plane individuale të mbështetjes sociale, në bashkëpunim me ekipin multidisiplinar;
- Ndjekë rastet e përfituesve gjatë gjithë procesit të ofrimit të shërbimit;
- Mbështesë përfituesit në proceset e përfshirjes sociale, komunitare dhe institucionale;
- Ofrojë këshillim social dhe orientim për familjet dhe kujdestarët;
- Ndërmjetësojë dhe koordinojë bashkëpunimin me institucione publike dhe shërbime të tjera sociale, shëndetësore apo arsimore;
- Kontribuojë në programet për jetesë të pavarur dhe gjysmë të pavarur për të rinjtë mbi 18 vjeç;
- Mbajë dokumentacion social dhe dosje individuale për secilin përfitues;

4. Kërkesat e përgjithshme të kualifikimit

- Diplomë universitare në Punë Sociale (Bachelor dhe Master);
- Licencë profesionale për ushtrimin e profesionit të Punonjësit Social, sipas legjislacionit në fuqi;



Fshati Prush, Komuna Vaqarr, Tirane-Albania
Mob:+355(0)682084945
E: info@helphthelife.org.al
W: www.helphthelife.org

- Përvojë pune në shërbime sociale për persona me aftësi të kufizuara (e dëshirueshme);
- Njohuri mbi politikat sociale, shërbimet komunitare dhe sistemin e mbrojtjes sociale;
- Njohuri mbi standardet dhe kuadrin ligjor të shërbimeve sociale.

5. Procedura e aplikimit

Kandidatët e interesuar, të cilët i plotësojnë kriteret e përcaktuara në këto Terma Reference, ftohen të dorëzojnë dokumentacionin e mëposhtëm brenda afatit të përcaktuar, jo më vonë se data 30.01.2026, ora 17:00:

- Letër motivimi, ku të shpjegohet interesi për pozicionin dhe mënyra se si kandidati/ja i plotëson kriteret e kërkuara;
- Curriculum Vitae (CV) e detajuar dhe e përditësuar;
- Kopje e diplomës Bachelor dhe/ose Master, sipas kërkesës së pozicionit;
- Kopje e licencës për ushtrimin e profesionit, sipas kërkesës së pozicionit;
- Dokumente të tjera mbështetëse (certifikata trajnimesh, referenca pune, etj.), nëse aplikohen.
- Vërtetim të gjendjes gjyqësore.

Dokumentet duhet të dorëzohen në adresën e email: info@helphthelife.org.al me subjekt : Aplikim per pune (duke specifikuar pozicionin e dëshiruar).

Vetëm kandidatët e përzgjedhur në listën e shkurtër do të kontaktohen për fazat e mëtejshme të procesit të përzgjedhjes.